

VENDIM
Nr. 555, datë 18.6.2015

**PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT
DHE TË MESME DREJTUESE EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË
SHËRBIMIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për vitin 2015, procedura e plotësimit të pozicioneve të lira të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, për të cilët lëvizja paralele është mbyllur pa fitues, të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendet e lira.

2. Numri maksimal i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, është:

- a) 20 pozicione për kategorinë e mesme drejtuese;
- b) 56 pozicione për kategorinë e ulët drejtuese.

3. Pozicionet, në të cilat mund të konkurrojnë edhe kandidatë nga jashtë shërbimit civil, për nivelin e mesëm drejtues, gjithsej 20, si dhe për nivelin e ulët drejtues, gjithsej 44, përcaktohen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja 1

**POZICIONET NË TË CILAT MUND KONKURROJNË EDHE KANDIDATË NGA JASHTË
SHËRBIMIT CIVIL**

I. Niveli i mesëm drejtues dhe të barazvlefshëm

1. Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Burimeve Ujore, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;

2. Drejtor i Drejtorisë së Krijimtarisë së Fjalës dhe Përkthimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit Strategjik për Artin dhe Kulturën, në Ministrinë e Kulturës;

3. Drejtor i Drejtorisë së Arkivit të Sistemit të MPB, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Punëve të Brendshme;

4. Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Transportit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave, në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës;

5. Drejtor i Drejtorisë së Projekteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Integritit, në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës;

6. Drejtor i Drejtorisë së Bashkëpunimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;

7. Koordinator (2 pozicione) në Departamentin e Jetësimit të Prioriteteve, në Kryeministri;

8. Koordinator i Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, në Zyrën e Menaxhimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm, në Kryeministri;

9. Koordinator në Zyrën (Drejtorinë) Operative të Situatës, në Kryeministri;

10. Drejtor i Sekretariatit Teknik (Drejtorisë) Sektori i Qeverisjes së Mirë dhe Administrimit Publik,

në Kryeministri;

11. Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Ndihmës së Huaj dhe Instrumenteve nga BE, në Njësinë e Programimit të Financimeve, në Departamentin e Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri;

12. Koordinator në Njësinë për Mbështetjen e Investimeve Strategjike të Biznesit, në Departamentin e Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri;

13. Koordinator në Drejtorinë e Menaxhimit të Ndihmës së Huaj, në Njësinë e Programimit të Financimeve, në Departamentin e Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri;

14. Koordinator në Njësinë e Kërkimit dhe Zhvillimit të Politikave, në Departamentin e Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri;

15. Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Rekrutimit të Administratës Publike, në Departamentin e Administratës Publike;

16. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Financave;

17. Drejtor i Drejtorisë së Pagesave dhe Dëmshpërblimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave;

18. Drejtor i Drejtorisë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë e Financave;

19. Drejtor i Drejtorisë së Integritit Evropian, Projekteve dhe Publikimeve, në Institutin e Statistikave, INSTAT.

II. Niveli i ulët drejtues dhe të barazvlefshëm

1. Përgjegjës i Sektorit të Kërkimit Shkencor, në Drejtorinë e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Arsimore dhe Planifikimit Strategjik, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;

2. Përgjegjës i Sektorit të Diasporës dhe Minoriteteve, në Drejtorinë e Arsimit Parauniversitar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Arsimore dhe Planifikimit Strategjik, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;

3. Përgjegjës i Sektorit të Kurrikulës, Cilësisë dhe Koordinimit, në Drejtorinë e Arsimit Parauniversitar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Arsimore dhe Planifikimit Strategjik, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;

4. Titullari i Entit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve, institucion i varësisë së Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;

5. Përgjegjës i Sektorit të Projekteve IPA dhe Donatorëve të Tjerë, në Drejtorinë e Integritit Evropian dhe Projekteve, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;

6. Përgjegjës i Sektorit të Lejeve dhe Monitorimit të Hidrokarbureve, në Drejtorinë e Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve, në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë;

7. Inspektor në Sektorin e Kërkesë-Ankesave, në Drejtorinë e Inspektimit të Përgjithshëm, në Ministrinë e Punëve të Brendshme;

8. Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit dhe Integritit të Sistemeve, në Drejtorinë e Sistemeve Informatike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë e Punëve të Brendshme;

9. Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, në Drejtorinë e Sistemeve Informatike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë e Punëve të Brendshme;

10. Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Regjistrit Kombëtar të Adresave, në Drejtorinë e Sistemeve Informatike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë e Punëve të Brendshme;

11. Përgjegjës i Sektorit të Projekteve IPA dhe Koordinimit me Donatorët, në Drejtorinë e Integritit Evropian dhe Projekteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit Strategjik dhe Integritit, në

Ministrinë e Punëve të Brendshme;

12. Kapiten i Portit Vlorë, në Drejtorinë e Përgjithshme Detare, institucion i varësisë së Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës;

13. Përgjegjës i Sektorit të Partneritetit Publik-Privat, në Drejtorinë e Projekteve, në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës;

14. Përgjegjës i Sektorit të Qirave dhe Monitorimit të Kontratave, në Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Shtetërore, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;

15. Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit dhe Vlerësimit të Projekteve të Investimeve Publike, në Drejtorinë e Monitorimit, Vlerësimit dhe Koordinimit të Prioriteteve të Politikave Ekonomike dhe Investimeve Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;

16. Përgjegjës i Sektorit të Zonave Ekonomike, në Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Shtetërore, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;

17. Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Tokës, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit të Territorit, në Ministrinë e Zhvillimit Urban;

18. Përgjegjës i Sektorit të Politikave të Urbanizimit të Zonave Informale, në Drejtorinë e Ndërtimeve Informale, Legalizimit dhe Urbanizimit, në Ministrinë e Zhvillimit Urban;

19. Përgjegjës i Sektorit të Dokumentacionit, në Njësinë e Legjislacionit dhe Akteve të Këshillit të Ministrave, në Departamentin e Legjislacionit, Monitorimit të Programeve dhe Antikorrupsionit, në Kryeministri;

20. Koordinator në Njësinë e Komunikimit Elektronik, Postar dhe Integritit, në Kryeministri;

21. Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Fondeve të IPA dhe Donatorëve të Tjerë, në Drejtorinë e Integritit dhe Projekteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Jetësimit të Prioriteteve, Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë dhe Integritit, në Ministrinë e Drejtësisë;

22. Përgjegjës i Sektorit të Integritit Evropian, në Drejtorinë e Integritit dhe Projekteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Jetësimit të Prioriteteve, Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë dhe Integritit, në Ministrinë e Drejtësisë;

23. Inspektor (7 pozicione) në Sektorin e Inspektimit dhe Organizimit Gjyqësor, në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë;

24. Sekretar i Përgjithshëm në Prefekturën Tiranë;

25. Titullar i Degës Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, Sarandë;

26. Titullar i Degës Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, Lezhë;

27. Përgjegjës i Sektorit të Akteve Ligjore, në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse;

28. Përgjegjës i Sektorit të Ndjekjes së Gjyqësorit, në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse;

29. Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit të Koncesioneve, në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse;

30. Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse;

31. Përgjegjës i Sektorit të Auditit Operacional, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm;

32. Përgjegjës i Sektorit të të Ardhurave, në Drejtorinë e Politikave Fiskale, në Drejtorinë e Përgjithshme Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale;

33. Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe Projekteve, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse;

34. Përgjegjës i Sektorit të Integritimit Evropian dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, në Drejtorinë e Integritimit Evropian dhe IPA;

35. Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Kontratave, në Drejtorinë e Financimeve dhe Kontraktimeve;

36. Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit të Infrastrukturës, në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse;

37. Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, Elbasan;

38. Përgjegjës i Sektorit të Verifikimit në Terren, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Korçë.